EUROPEAN CENTRE FOR MINORITY ISSUES KOSOVO

PRESS RELEASE

Kumtesë për Media
13 SHTATOR 2023

PAJISJE TË REJA PËR QENDRAT SHËNDETËSORE NË RAJONIN E DUKAGJINIT.

Pajisje të reja për mbrojtjen e shëndetit riprodhues u prezantuan dhe u dorëzuan zyrtarisht në rajonin e Duakgjinit, të cilat u blenë për qendrat shëndetësore të Spitalit Rajonal të Pejës dhe Gjakovës si dhe për qendrat kryesore të mjekësisë familajre në Klinë, Istog dhe Deçan në kuadër të projektit CARES 2, i cili po zbatohet në Kosovë nga ECMI Kosova. Vlera totale e pajisjeve të blera është 53,720.00 EUR, e cila përbëhet nga dy pajisje ultratinguj, kolposkop dixhital me kamerë, amnioskop, aspirator me vakum, tavolinë për lindje dhe ekzaminimi gjinekologjik, monitor për pacient, sterilizues dhe grupe instrumentesh dhe kimikate për testin PAPA. Projekti CARES 2 – Aktivitetet ndërkufitare në sektorin e shëndetit riprodhues financohet nga Bashkimi Evropian përmes Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë*. Autoriteti kontraktues për projektin është Ministria e Financave e Malit të Zi - Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Fondeve të Mbështetjes së BE-së.

Projekti në Kosovë zbatohet nga ECMI Kosova – Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë, në komunat Pejë, Gjakovë, Klinë, Istog dhe Deçan. Qëllimi i projektit është të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në sektorin e shëndetit riprodhues dhe të informojë qytetarët për rëndësinë e parandalimit dhe ruajtjes së shëndetit riprodhues.

Përveç blerjes së pajisjeve të reja, aktivitete të tjera të shumta janë zbatuar deri më tani, duke përfshirë trajnim për staf mjekesësorë, ligjerata mbi parandalimin e kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës, shpërndarjen e dy broshurave dhe shpërndarjen e materialeve promovues që përmbajnë një mesazh në lidhje me rëndësinë e parandalimit, transmetimi i videos , fushata mediatike dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Një aktivitet shumë i rëndësishëm i projektit është gjithashtu fushata e organizimit të ekzaminimeve parandaluese, e cila kryhet në bashkëpunim me qendrat shëndetësore dhe spitalet në komunat e synuara.

Ne e përdorim këtë mundësi për t'i kujtuar grave dhe vajzave të reja që të kryejnë rregullisht ekzaminime parandaluese dhe kështu të kontribuojnë në ruajtjen e shëndetit. Kontrollet e rregullta mund të lehtësojnë shumë trajtimin e sëmundjeve të caktuara malinje, dhe në disa raste madje parandalojnë plotësisht shfaqjen e tyre.

Për më shumë informacione mund të kontaktoni znj. Blerta Visoka nga ECMI Kosovo – Zyrtare e Programit në tel: +383 (0) 38 224 473.

*Ky mbishkrim nuk paragjykon statusin e Kosovës dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovë.

Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian

MNE – KOS
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020

PRESS RELEASE

Rreth ECMI Kosovo

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të minoriteteve në Kosovë, me qëllim kryesor për të zhvilluar institucione gjithëpërfshirëse, përfaqësuese, të ndjeshme ndaj komunitetit që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme dhe multi-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, mbështet institucionalizimin e organeve qeveritare të lidhura me komunitetet dhe rrit aftësinë e aktorëve të shoqërisë civile dhe qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin në një mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.